

Njoftim për pagën minimale dhe maksimale nga periudha Shtator 2022

Të nderuar tatimpagues!

Ju bëjmë me dije se, duke filluar nga **periudha Shtator 2022**, paga bazë minimale mujore, në shkallë vendi për punonjësit, e detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo person juridik apo fizik, vendas apo i huaj, është **34,000 lekë**. (VKM nr. 604, datë 14.09.2022)

Për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, paga bruto mujore, do të jetë:

1. Jo më pak se sa paga minimale mujore, e barabartë me **34,000** (tridhjetë e katër mijë) lekë dhe deri në **149,954** (njëqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë, për personat e punësuar;
2. Jo më pak se paga minimale, e barabartë me **34,000** (tridhjetë e katër mijë)lekë dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri në **149,954** (njëqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë, për personat e vetëpunësuar;
3. E barabartë me pagën minimale mujore prej **34,000** (tridhjetë e katër mijë) lekë, për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton ligjërisht.

Gjithashtu, **për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimit shëndetësor**, paga mujore do të jetë:

1. Jo më pak se sa paga minimale mujore në shkallë vendi, prej **34,000** (tridhjetë e katër mijë) lekë dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar;
2. Sa dyfishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej **68,000** (gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton.